



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

Numri i Ceshtjes :	58339-01311-61-2020	Data e Regjistrimit :	15/07/2020
Numri i Vendimit:	61-2020-4261	Data e Vendimit :	14/10/2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Mirela Mishgjoni

SEKRETARE: Iva Llupa

Sot më datë 14/10/2020 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Të pandehurit: Xxxx, i biri i xxxdhe i ., i datëlindjes xxx

Akuzuar: Gjykim I proçedimit penal nr. xxxx në ngarkim të pandehurit Xxxx, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 287 K.Penal

VEREN :

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR VLORE

Nr.387 Regjistri Themeltar Nr. 295 Vendimi

Data e regjistrimit 15.07.2020

VENDIM

“Ne Emer te Republikes”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, e perbere nga:

Mirela MISHGJONI I GJYQTARE

Asistuar nga sekretare e séances gjyqesore Iva Llupa, ne Vlore, me date 14.10.2020, ora 10.15, ne séance gjyqesore me dyer te hapura, shqyrtoi ceshtjen penale nr.387 akti, qe i perket:

KERKUESE: Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore, e perfaqesuar nga prokuror xxxx.

KUNDER:

Xxxx, i biri i xxxx, i datelindjes 23.04.196 banues ne Vlore,

Lagje “xxxx”, shtetesia shqiptare, gjendja civile i divorcuar, gjendja gjyqesore i pa denuar, hetuar pa mase sigurimi, ne mungese, perfaqesuar ne baze te prokures se posacme nrxxxxxxx, nga Av. xxxx, anetare e Dhomes se Avokatise

Tirane, nr.xxxxxxxx nipti, ne mungese ne shpalljen e vendimit.

AKUZUAR:

Per kryerjen e vepres penale te “Pastrimi i produkteve te vepres veprimtarise kriminale”, parashikuar nga neni 287/a/b/c i Kodit Penal.

OBJEKTI: Kerkese per gjykimin e te pandehurit Xxxx.

Gjykata, pasi shqyrtoi ceshtjen, ne mungese te te pandehurit, ne proceduren e gjykimit te shkurtuar, administroi dhe shqyrtoi provat ne teresi, degjoi palet ne konkluzionet perfundimtare qe kerkuan:

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore:

- Deklarimin fajtor te te pandehurit xxxx “Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale”, dhe ne baze te nenit 287/a/b/c te Kodit Penal denimin e tij me 5 vjet burgim.

- Aplikimin e nenit 406 te Kodit te Procedures Penal

- Ne baze te nenit 59 te Kodit Penal pezullim periudhe kohore tre vjet.

- Sendet e sekuestruara me vendimin me Nr.

Rrethit Gjyqesor Vlore si me poshte:

- Garazh me nr.x dhe garazh nr. x, me sip tot

Korriku”, objekt banimi 6-8 kate, 1-kat dyqan, 5-7 kate +1-kat parkim ne toke, blere per cmimin e **12.000**

Euro, blere me kontraten me nrxxxxx ndermjet shoqerise “Ita” mobiliare dhe shtetasit Xxxx, **te**

konfiskohet dhe te kaloje ne favor te shtetit.

- Vendparkim nr.xxxx.14, ndod kate parkim nen toke, sipas lejes se ndertimit miratuar me vendimin me Nr.xxxxxxx, ne lagjen “xxxx” Vlore, blere nga shtetasi Xxxx per cmimin e

40.000 Euro. Para nenshkrimet te kesaj kontrate eshte likujduar shuma prej **20.000 Euro**, pjesa e mbetur ne vijim deri ne dt 28/02/2015, blere me kontraten e premtim shitjes me nr.xxxxx kol, date 12/10/2012, lidhur ndermjet shoqerise xxxxsh.p.k dhe shtetasit Xxxx, **te konfiskohen dhe te kalojne ne favor te shtetit.**

- utomjet tip BMW X5, me targe xxxxx, me prodhimi 2008, i blere ne shumen prej 22.000 euro, **te konfiskohet dhe te kaloje ne favor te shtetit.**

- Dyqan me sip 57 m2, ndodhur ne nje objekt 13- sipas lejes se ndertimit miratuar me vendimin me Nrxxxxx te KRRT-se Bashkise Vlore,

ne lagjen "xxxxxxx" Vlore , blere me kontraten e premtim shitje dyqani, me nr.xxxxxxxxxx kol dt 23.08.2014, ndermjet shoqerise "xxxxxxx sh.p.k dhe shtetasit xxxxxxxx per cmimin e **25.000 euro** Euro, te hiqet masa e sigurimit pasuror te sekuestros preventive dhe ti kthehet pronarit te ligjshem shtetasit xxxxxxxx.

- Apartament banimi nr.9/B me sip 65 m2 dhe gar lagjen "10 Korriku", objekt banimi 6-8 kate, 1-kat dyqan, 5-7 kate +1-kat parkim ne toke, blere per

cmimin e **37.000 Euro**, blere me kontrate porosie me nr.1011 Rep dhe nr. 425 Kol dt.08.08.2012, ndermjet shoqerise xxxxxxxx dhe shtetasit xxxxxxxx per apartament xxxxxxxx, te hiqet masa e sigurimit pasuror te sekuestros preventive dhe ti kthehet pronarit te ligjshem shtetasit xxxxxxxx.

-Apartament banimi nr xxxxxxxx me sip 62 m2 dhe totale 28.9 m2, ndodhur ne lagjen "xxxxx", objekt banimi xxxxxxxx

parkim ne toke blere per cmimin e **35.000 Euro**, lagje "xxxxxxx" Vlore, blere me kontrate siper marrje per prenotim apartamenti nrxxxxxxxxxxxx, lidhur ndermjet shoqerise "xxxxxxx" dhe shtetasit xxxxxxxx, te hiqet masa e sigurimit pasuror sekuestro preventive dhe ti kthehet pronarit te ligjshem shtetasit xxxxxxxx.

- Njesi sherbimi dyqan, me sip 43.8 m2, ndodhur cmimin e **135.780 euro**, blere me kontraten me nr.xxxxxx, kontrate premtim shitje, lidhur ndermjet shtetasit xxxxx dhe shtetasit Xxxx, pasuri e cila me pas i ka kaluar shtetases xxxxxx,te hiqet masa e sigurimit pasuror sekuestro preventive dhe ti kthehet pronarit te ligjshem shtetases xxxxxxxxxxxxxxx.

- Shpenzimet procedurale te kryera gjate hetim gjate gjykimit, ti ngarkohen te pandehurit.Mbrojttesi i te pandehurit Xxxx, Av. xxxxx:

- Deklarimin e pafajshem te te pandehurit Jxxxxnje denimi me te ulet dhe aplikimin e nenit 59 te Kodit Penal.

- Heqjen e sekuestros mbi sendet e sekuestruara me vendimin nr/xxxxx xxx te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore.

VEREN

Me kerkesen objekt gjykimi Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore ka kerkuar gjykimin e ceshtjes penale ne ngarkim te te pandehurit Xxxx i akuzuar per kryerjen e vepres penale te "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", te parashikuar nga neni 287/a/b/c i Kodit Penal.

Perpara fillimit te shqyrtimit gjyqesor i pandehuri kerkoj te zhvillohej gjykimi me pro gjykimit te shkurtuar, kerkese per te cilen prokurori u shpreh dakort.

Gjykata ne baze te neneve 403 dhe 405 te Kodit te Proçedures Penale, vendosi kerkesen dhe zhvilloi gjykimin me proçeduren e gjykimit te shkurtuar pasi konstatoi se i pandehuri kishte paraqitur kerkese per gjykim te shkurtuar ne seancen paraprake ne perputhje me parashikimet e nenit

332/c te Kodit te Procedures Penale, kerkese e cila u perserit perpara fillimit te shqyrtimit gjyqesor dhe ceshtja mund te zgjidhej ne gjendjen ne te cilen ndodheshin aktet e hetimit paraprak, pa u cenuar te drejtat e paleve dhe dhenia e drejtesise.

Nga gjykimi i shkurtuar me spjegimet e paleve dhe provat shkresore te administruara ne gjykim rezultuan te vertetuara keto rrethana fakti:

I pandehuri Xxxx eshte banor i Bashkise Vlore. Ne daten 21.02.2018, nga Oficeret e Policise Gjyqesore te Sektorit Kunder Krimet Ekonomiko-Financiar ne Drejtorine Vendore te Policise Vlore eshte

referuar ne Prokurorine prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore informacioni se shtetasi Xxxx, eshte i perfshire ne aktivitetin e paligjshem te trafikimit te lendeve narkotike, duke e perqendruar kete aktivitet ne qytetin e Romes, Itali. Ne rrethana te tilla eshte regjistruar procedimi penal nr.406/2018 per vepren penale te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe jane kryer hetime ne lidhje me faktet e referuara.

Nga verifikimet e kryera prane Kartotekes se Drejtorise Vendore te Policise Vlore, ka rezultuar se shtetasi Xxxx eshte person i evidentuar nga strukturat policore, per aktivitet kriminal prej vitit 1995 e ne vazhdim, per "Mbajtje pa leje te armeve te zjarrit", "Trafikim te lendeve narkotike" dhe "Kundershtim te punonjesit te policise", precedent ky i fundit i ndodhur ne Itali ne vitin 2017.

Nga verifikimi prane Deges se ALUIZNI Vlore, me shkresen nr.xxxx, ka rezultuar se shtetasi Janaq xxxxx ka aplikuar per legalizim objekti informal me formularin nr.xxxxx, dhe eshte pajisur me leje legalizimi per objekt me sip.ndertimi xxxx pasuria nr xxxx Vlore.

Nga verifikimi prane ZVRPP Vlore me shkresen nr.xxxxx ka rezultuar se shtetasi Xxxx ka te rregjistruar pasurine nr xxxxx, e llojit banese me siperfaqe 182 m2, dy kat, ne lagjen "xxxx" Vlore.

Nga analiza e te dhenave te siperpermendura te grumbulluara, rezulton se ne pronesi te shtetasit Xxxx jane dy banesa 1-2 kateshe ne xxxx Vlore; dy apartamente banimi kaluar ne pronesi te dy djemve te tij ne lagjen "xxxx" Vlore (mbrapa dyqanit xxxx); njesi sherbimi ne lagjen "xxxx (pallati shumekatesh prane xxxxx) e prenotuar ne vitin 2012, per vleren e 135.780Euro; garazhd po ne kete objekt me vlere 40.000 Euro; dhenie hua shuma prej 150.000 Euro; shitje automjeti ne vleren e 30.000 Euro; automjet BMV X5 prodhim vitit 2008; te dhenat nga sistemi bankar ku rezultojne depozitime e terheqje ne vleren e rreth 61.000 Euro.

Nga shkresa nr.553, date 26.07.2018, ardhur nga Zyra Europol Tirana rezulton se shtetasi Xxxx, xxxxx, ne date 09.11.1991 deri ne date 23.05.2017, eshte kontrolluar disa here, daktiloskopuar nga autoritetet Italiane per veprat penale, Kercenim, Kundershtim, Prekje paligjshme e nje oficeri public, rezistence ndaj arrestimit, per arsye te sigurise publike, prodhim dhe trafik droge, grindje. Ne date 14.06.2001 ai eshte arrestuar dhe denuar nga xxxxx, me 9 vjet burgim per prodhim dhe trafik droge, anetaresim ne nje organizate kriminale e cila merret me trafik droge.

Po keshtu te kontrolluar dhe daktiloskopuar jane edhe dy djemte e tij shtetasit xxxxxxx e ish bashkeshortja tij xxxx, per arsye te sigurise publike. Eshte administruar informacion nga Qendra Rregjistrimit te Aksioneve, Drejtoria e Drejtimit te Prones Publike, xxxx, ku nuk rezulton asnje e dhene per personat objekt hetimi.

Eshte administruar informacion nga DRSHTRR Vlore ne lidhje me dosjen e automjetit me targe xxxxxxx ne pronesi te Xxxx, autoveture markes BMV X5, prodhim vitit 2008, blere ne date 31.05.2012, per shumen e 22.000 Euro. Eshte administruar shkresa nr.xxxxx, ardhur nga Drejtoria Doganes Tirane ku rezultojne zhdoganime: Xxxx, xxxxx, pajisje per palester; Xxxx, automjet i perdorur xxxxxx.

Eshte administruar informacion nga Banka e Shqiperise ku asnje prej personave objekt hetimi nuk kane hapur llogari prane kesaj banke. Eshte kerkuar dhe administruar nga bankat e nivelit te dyte, informacion mbi numrat e llogarive bankare, kopje te veprimeve mbi keto llogari bankare, pra mbi veprimtarine financiare per personat objekt hetimi.

Jane administruar prane xxxxx keto akte noteriale: Kopje kontrate nr.xxxxx, kontrate premtim shitje ndermjet shtetasit xxxxxx dhe shtetasit Xxxx per shitje

dyqani Nr.xxxx, ne katin e pare nga toka me sip 43.8 m2, per cmimin e 135.780 euro. Para nenshkrimit te kontrates eshte likujduar shuma prej 67.890 Euro, ne momentin e dorezimit do te likujdohet shuma

57.890 Euro, me nenshkrimin e kontrates do te likujdohet diferenca prej 10.000 Euro; Kopje deklarate noteriale me nr.xxxxxxxxxx, lidhur ndermjet shtetasve xxxxxxxxxxxxxxxx dhe Xxxx, ku ne vijim te kontrates se lartpermendur deklarojne se Xxxx ka paguar jashte zyres noteriale shumen prej 57.890 Euro duke i ngelur per te paguar vetem diferenca prej 10.000 Euro; Kopje kontrate premtim shitje vend parkimi, me xxxxxxxxxxxx, lidhur ndermjet shoqeria Hanxhari sh.p.k dhe shtetasit Xxxx per vendparkim nr.xxxxxxxxxx dhe vendparkim nr.xxx, per cmimin e 40.000 Euro. Para nenshkrimit te kesaj kontrate eshte likujduar shuma prej 20.000

Euro, pjesa e mbetur ne vijim deri ne dt 28.02.2015; Kopje kontrate premtim shitje dyqani, me xxxxxxxxxxxx, lidhur ndermjet shoqerise xxxxx sh.p.k dhe shtetases xxxxx, per dyqan me sip 69.5 m2 per cmimin e 30.000 Euro. Palet kane deklaruar se kjo pagese eshte likujduar totalisht jashte zyres noteriale me pagese bankare; Kopje kontrate premtim shitje dyqani, me nrxxxxx kol dt 23.08.2014, ndermjet shoqerise xxxxi dhe shtetasit xxx, per shitje dyqani me sip 57 m2 per cmimin e 25.000 Euro. Palet kane deklaruar se kjo shume do te shlyhet brenda dates 26.08.2014 pas nenshkrimit te kesaj kontrate jashte zyres noteriale.

Jane administruar prane notere xxxxxxxx keto akte noteriale: Kopje kontrate me nr.xxxxxxxxxx dt 08.01.2013, per dhenie huaje, ku shtetasi Xxxx i jep hua shtetasit xxxxxxxxxxxx shumen prej 150.000 Euro me afat kthimi deri ne daten 10.03.2013; Kopje kontrate shitje automjeti nr.934/593, date 26.04.2016, ku Xxxx i shet autoveture xxxxxxxx per shumen e 30.000 Euro.

Jane administruar prane Notere xxxxxxxxxxxx keto akte noteriale: Kopje kontrate nr.547/271, date 11.05.2013, ndermjet shoqerise xxxx dhe Xxxx, per shitje garazhi nr.xxxxxxx, me sip totale 31.5 m2 per cmimin e 12.000 Euro, adrese xxxxx Vlore; Kopje kontrate sipermarrije per prenotim nr.543/267, date 10.05.2013, ndermjet shoqerise xxxxxxxx dhe shtetasit xxxxxxxxxxxx, per apartament banimi xxxxxxxx me sip 62 m2, dhe garazh nr.xxxxxxx

28.9 m2, per cmimin e 35.000 Euro lagje“xxxxxxx; Kopje kontrate porosi per prenotim nr.1011/425, date 08.08.2012, ndermjet xxxxxxxxxxxx xdhe xxxxxx per apartament banimi nr.9.B, me sip 65 m2, dhe garazh nr.14, garazh nr.15, per cmimin e 37.000 Euro, lagje “10 Korriku” Vlore.

Me shkresen nr.448/1, date 25.07.2018, ardhur nga ZVRPP Vlore, rezultojne te regjistruara keto pasuri: Pasuria nr xxxx 2, ZK 8605, xxxxxx ne pronesi te shtetasit xxxxx, perfituar me Leje legalizimi, viti 2016; Objekt dy kate, me sip banimi 182 m2,

Pasuria nr xxxxx 1, ZK 8605, xxx, ne pronesi te shtetasit xxxxx, perfituar me Leje legalizimi, viti 2016. Objekt banimi nje kat me sip 118 m2 (te dy keto pasuri jane te ndertuara mbi nje siperfaqe toke prej 711.5 m2, perfituar me Vendim nr.xxxx, te Gjykates se Shkalles se pare Vlore, ne pronesi te babait te tij shtetasit xxx); Apartament banimi me sip 91.6 m2, ZK 8605, vol xxx ne pronesi te xxx, blere ne date 07.05.2013, sipas kontrates noteriale xxxx, te notere xxx, per vleren e 20.000 Euro.

Nga hetimi pasuror i kryer ndaj shtetasit Xxxx dhe personave te lidhur me te, jane evidentuar disa pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, te cilat me vendimin me nr.2029 date 17.11.2018, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, jane vendosur nen masen e sigurimit pasuror te sekuestros preventive.

Ne funksion te hetimeve, eshte derguar leterporosi autoriteteve gjyqesore italiane, me qellim marrjen e te dhenave ne lidhje me shtetasin Xxxx, sa i perket denimeve eventuale, procedimeve penale

apo te ardhurave te perftuara nga ky shtetas ne territorin italian.

Me shkresen me nr.xxxxx, te derguar nga ana e Ministrise se Drejtesise Tirane, eshte transmetuar e perkthyer leterporosia e derguar nga autoritetet italiane, sa i perket shtetasit Xxxx.

Referuar permbajtjes se akteve te derguar me ane te leterporosise, rezulton si me poshte: Ne date 16.12.1996, eshte arrestuar shtetasi Xxxx per kryerjen e veprave penale te parshikuara nga nenet 71 dhe 72 dhe ligjit 685-1975 (posedim te lendeve narkotike mbi sasine e lejuar) si dhe per vepren sipas Dekretit te Presidentit te Republikes 309-90, neni 73. Per veprat e lartepemendura eshte marre masa e burgimit. Me date 24.06.2004, eshte lene i lire nga Instituti i burgimit ne Napoli, Secondigliano, pasi ka shlyer denimin me detyrim paraqitjen prane Kuestures ne Napoli, Zyra e te Huajve. Ne date 03.01.1997, eshte sinjalizuar nga Grupi i Gatshem ne xxx si xxxx, lindur me 23.04.1969, ne Shqiperi. Po ne date 03.01.1997, eshte sinjalizuar si xxxxx, lindur me 23.04.1969 ne Shqiperi. Me date xxxx, Gjykata e Apelit ne Lecce, me vendimin me nr.xxxx dhe 1205/98 RG, ka riformuluar vendimin e Gjykates ne Lecce, me date

17.11.1997 duke ripercaktuar denimin me 9 (nente) vjet heqje lirie, per veprat sipas neneve 71 dhe 72 dhe ligjit 685-1975. Ne xxxx, eshte sinjalizuar nga Policia e Burgut ne Voghera, ku vuante denimin, se ne bashkepunim me te denuar te tjere ka provokuar sherr ne ambientet e kopshtit te burgut. Ne date 23.08.2003, eshte sinjalizuar nga Policia e burgut ne xxxxx, ku vuante denimin, se ne bashkepunim me te denuar te tjere ka provokuar sherr. Ne date xxxxx i eshte bere me dije dekreti i refuzimit te leshimit te lejes se qendrimin, i leshuar nga kuestori ne xxxx date 11.02.2013, eshte fotosinjalizuar ne kuader te operacionit "RING NEE", te kryer nga ushtarake te grupit hetimor kunder kriminalitetit te organizuar te Brescias, ku u arrestua xxxx sipas nenit 73 te Dekretit te Presidentit te Republikes 309/90, pasi iu gjeten ne total 1340 kg marijuane. Kjo ngjarje ndodhi ne komunen e Aprilias. Ne date 23.02.2017, eshte sinjalizuar per dhune ose kercenim ndaj nje nepunesi sipas nenit 336 i k.p dhe rezistence ndaj nepunesit zyrtar sipas nenit 337 te k.p, nga Karabinieret e stacionit C.C ne Rome-Appia. Ne date 24.02.2017, Gjykata e Romes, e gjykoi arrestimin e kryer nga Karabinieret e Romes-Apias, si te ligjshem dhe vendosi ndryshimin e mases me detyrim paraqitje. Ne date 19.05.2017, Gjykata e Romes e denoi Xxxx, per veprat sipas neneve 336 dhe 337 te k.p dhe vendosi pushimin e detyrimit te paraqitjes prane policise gjyqesore.

Po keshtu sipas akteve te transmetuara me ane te leterporosise, rezulton se nga verifikimi i Regjistrat te Gjendjes Gjyqesore prane Ministrise se Drejtesise, ne ngarkim te Xxxx, rezulton vetem nje denim, i leshuar nga Gjykata ne Lecce, me date 17.11.1997, i cili ka marre forme te prere me date 10.12.1999, me 9 vjet heqje lirie, sipas neneve 73 dhe 74 te Dekretit te Presidentit te Republikes 309/90.

Po keshtu rezulton se subjekti i eshte nenshtruar nje kontrolli ne date 24.04.2019, te kryer nga Komanda e Stacionit te Karabinierëve te Torvaianica (RM) ne Pomezia (RM), ne rrugen Francoforte, ne prani te zxxxxx, lindur ne 07.03.1995 ne Shqiperi dhe banues ne Pomezia, ne rrugen Lungomare delle Sirene nr.166. Me pas jane kryer verifikime prane Zyres se Gjendjes Civile te Komunes se Pomezia, çertifikata e gjendjes familjare te xxxxx.

Lidhur me te ardhurat e ligjshme te perftuara nga ana e shtetasit Xxxx ne Itali, nga informacioni i administruar me ane te leterporosise, rezulton se: Viti 2000 - Rezulton te kete perfituar te ardhura por nuk eshte e mundur te verifikohet shuma apo punedhenesi; Viti 2001 - 1.110.00 euro, Çertifikate pune e leshuar nga Drejtoria e Burgjeve ne xxxxxxxx 2002 - Te ardhura te paperftuara;

Viti 2003 - 530 euro, Çertifikate pune e leshuar nga Drejtoria e Burgjeve xxxx-F xxxxx

Viti 2004 - Percaktohet vetem punedhenesi (te dhenat nga pagesat e taksave)

Çertifikate pune e leshuar nga xxxx, xx

Nga verifikimet e kryera nga ana e autoriteteve italiane ne sistemin Sister te Agjencise se te Ardhurave-Territor, rezulton se shtetasi Xxxx, nuk posedon pasuri te paluajtshme. Rezulton se ish bashkeshortja e tij xxxx, ne date 14.02.2008, ka blere nje pasuri te paluajtshme ne xxxx, te regjistruar ne fleten xxxxx sub xxxx me vleren e 124.073 euro, duke marre nje kredi hipotekore ne shumen e 108.000 euro me xxxx sh.a.

Po keshtu referuar informacionit te percjelle nga ana e autoriteteve italiane te drejtesise, rezulton se nga dokumentacioni i disponuar prej tyre, nuk eshte e mundur te percaktohet nese shtetasi Xxxx ka perfituar te ardhura ne rruge te paligjshme dhe cila eshte shuma e perftuar.

Lidhur me faktet e mesiperme, jane administruar deklarimet e xxxxx, xxxx.

Ne deklarimet e dhena nga shtetasja xxxxx rezulton se qe prej vitit 1997 ka jetuar ne Itali, fillimisht ne qytetin e xxx dhe me pas ne Rome. Ajo ka qene e martuar me shtetasin Xxxx, por qe prej vitit 2006 eshte divorcuar me kete shtetas dhe aktualisht ajo jeton me dy djemte e saj te quajtur xxx. Pas divorcit ajo e ka punuar ne pune te ndryshme ne Rome ndersa ne vitin 2007 ka hapur nje aktivitet privat qe konsistonte ne ofrimin e sherbimeve te fizioterapise, profesion per te cilin ajo deklaronte se ka kryer kurse te meparshme. Ky aktivitet eshte i regjistruar ne organet fiskale te shtetit italian. Nga ky aktivitet ajo shpjegon se ka pasur te ardhura mujore rreth 1500-2000 euro dhe gjithashtu ka punuar edhe jashte orarit te punes duke ushtruar profesionin e fizioterapistes edhe ne ambiente te ndryshme si banesa, etj. Nderkohe ajo thekson se eshte ndihmuar ekonomikisht edhe nga motra e saj Brunilda Hodo, e cila punon si mjeke ne spitalin "Villa Silvana" ne Rome.

Lidhur me veprimet juridike te blerjes se pasurive te paluajtshme qe jane evidentuar gjate hetimit, shtetasja xxxx ka sqaruar se burimi i te ardhurave lidhur me keto blerje, kane qene kursimet nga puna e saj ne Itali duke filluar nga viti 1997. Ajo sqaron se ne periudhen kur jane blere keto pasuri, ajo ka qene e divorcuar me shtetasin Xxxx. Ne funksion te deklarimeve te mesiperme, nga ana e shtetases xxxxx jane dorezuar disa dokumenta te njesuara me origjinalin qe provojne te ardhurat e saj ne Itali si dhe dokumentacion te njesuar me origjinalin te organeve fiskale italiane qe provon regjistrimin e aktivitetit te saj si dhe te ardhurat nga ky aktivitet. Po keshtu nder te tjera kjo shtetase ka dorezuar te njesuar me origjinalin edhe vendimin gjyqesor me objekt zgjidhjen e marteses me shtetasin Xxxx, fakt ky i ndodhur ne vitin 2006.

Rezulton se me vendimin gjyqesor me nr.839, date 08.05.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, ka vendosur: *"...Te zgjidhe martesen midis paditeses xxx dhe te paditurit Xxxx...Lenien e femijeve xxxx i datelindjes 26.09.1993 dhe xxxx i datelindjes 07.03.1995, xxx. I padituri ka te drejten e takimit te femijeve javen e pare dhe te trete te çdo muaji, duke filluar nga ora 10:00 e dites se shtune deri ne oren 10:00 te dites se diele dhe nga data 1-15 Gusht..."*. Ky vendim ka marre forme te prere pasi nuk eshte ankimuar.

Ne deklarimet e dhena prej tyre, shtetasit xxxxxx, kane shpjeguar faktin se burimi i te ardhurave per blerjen e pasurive te paluajtshme ne qytetin e Vlores, kane qene te ardhurat e te emes se tyre Elvira Hodo, si dhe kursimet e tyre nga puna ne Itali.

Per nevoja te hetimit, eshte pyetur ne cilesine e personit qe tregon rrethana te hetimit shtetasja Brunilda Hodo, e cila eshte motra e shtetases xxx. Ne deklarimet e dhena prej saj, ajo ka sqaruar se ka emigruar ne Itali ne vitin 2002 pasi ishte diplomuar me pare ne Shqiperi per mjekesi. Ne vitin 2005, ajo deklaronte se ka filluar pune si mjeke fiziatre ne spitalin "xxxxx" ne Rome dhe eshte e martuar me shtetasin italian xxxx Ajo sqaron se per shkak te gjendjes se mire ekonomike qe ajo dhe

bashkeshorti i saj kane, ka ndihmuar ekonomikisht edhe motren e saj Elvira Hodo dhe qe prej vitit 2015 ajo i kalon asaj ne rruge bankare nje shume prej 500 euro ne muaj. Po keshtu ne vitin 2007, ajo deklaroi se i ka kaluar motres se saj xxxxxs, nepermjet bankes "xxx", nje shume prej 17.500 eurosh, pasi i nevojiteshin per disa prona qe ajo po planifikonte te blinte ne qytetin e Vlores. Ne lidhje me deklarimet e dhena nga ana e xxx, lidhur me dhurimin nga ana e xhaxhait te saj te nje shume prej 25.000 eurosh ne vitin 2009, eshte pyetur shtetasi xxxx (djali i xhaxhait te shtetases xxx Ne deklarimet e dhena nga ana e ketij shtetasi, ai ka pranuar faktin se shtetases xxxx eshte dhuruar nga ana e familjes se tij nje shume prej 25.000 eurosh, te cilat jane transferuar ne llogarine e saj bankare ne Itali, nepermjet xxx. Shtetasi xxxx deklaroi se kete veprim e ka kryer per shkak te kerkeses se babait te tij si dhe duke patur parasysh veshtiresite qe ajo kishte kaluar. Po keshtu ky shtetas sqaron se transferta eshte bere nepermjet llogarise bankare te xxx, i cili eshte bashkeshorti i tezes se xxxx me vertetesine e fakteve te mesiperme, eshte kerkuar informacion prane "xxx" lidhur me transferen e mesiperme dhe sipas pergjigjes se sjelle nga ana e institucionit financiar te mesiperme, konfirmohet se ky veprim ka ndodhur realisht. Konkretisht rezulton se nga llogaria bankare e shtetasit xxx, ne favor te shtetases xxx eshte kaluar shuma prej 25.000 eurosh. Transferta eshte kryer nepermjet xxx

Gjate hetimeve te kryera, eshte pyetur edhe shtetasja xx, e cila eshte e ema e shtetases xxx Ne shpjegimet e dhena, kjo shtetase ka sqaruar faktin se ne vitin 2015, ka shitur banesen e saj te ndodhur ne lagjen "xxx qytetin e Vlores, me siperfaqe prej 134m², ne shumen prej 45.000 eurosh. Po keshtu ajo deklaroi se vajza e xxxx e cila ndodhet ne Itali dhe punon si mjeke, e ka ndihmuar vazhdimisht dhe ato se bashku kane edhe nje llogari bankare ne shumen prej 5000 eurosh. Lidhur me blerjen prej saj te nje qyani dhe nje garazhi te ndodhur ne lagjen "Pavaresia" Vlore, kjo shtetase deklaroi se keto dy pasuri ajo ja ka blere ish-dhendrrit te saj shtetasit Xxxx. Ajo sqaron se ai per shkak te disa problemeve shendetesore, kishte vendosur te shiste dy pasurite e mesiperme. Kete fakt ajo deklaroi se e ka mesuar nga dy nipat e saj xxxxx. Nder te tjera ata i kishin kerkuar qe ajo ti ndihmonte duke blere ambjentet e mesiperme, me qellim qe ata ti perdornin me pas per te ushtruar aktivitet ne fushen e fizioterapise. Ne keto kushte ajo deklaroi se ka vendosur te bleje nga ish-dhendrri i saj dy pasurite e mesiperme.

Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se me kontraten e shitjes se pasurise me nr.1168/583, date 13.07.2015, shtetasja xxx ka shitur pasurine e llojit apartament, me siperfaqe prej 57.5m², shtetasve xxx. Rezulton se cmimi i shitjes ka qene 47.000 euro nga te cilat 41.195 euro kane kaluar me ane te bankes xxx.

Nga verifikimet e kryera, rezulton se veprimi i mesiperme, eshte formalizuar me ane te kontrates per cedimin e te drejtave pasurore me nrxxx, lidhur midis shtetasit Xxxx ne cilesine e pales shitese dhe shtetases xxxx, ne cilesine e pales blerese. Referuar kontrates se mesiperme, rezulton se shtetasi Xxxx i detyrohej per te shlyer pronareve te dyqanit nje shume prj 10.000 eurosh sipas deklarates noteriale me nrxxx, dhe per shkaqe objektive qe lidheshin me problemet financiare te shtetasit Xxxx, kete pasuri ka vendosur t'ja shese shtetases xxxx, ne shumen prej prej 60.000 GBP Paund, (8.608.200 leke me kursin zyrtar). Pasuria eshte e llojit "Dyqan", me siperfaqe prej 43m². Nga te dhenat e administruara nga ana e xxx, rezulton se veprimi i mesiperme, eshte kryer ne rruge bankare dhe shuma e mesiperme ka kaluar nga llogaria e shtetases xxxx per tek llogaria e shtetasit Xxxx. Ne funksion te hetimit ne lidhje me sa me siper, jane administruar nje sere dokumentash te noterizuara

me vule apostille dhe te perkthyer nga gjuha italiane, dokumenta keto te vena ne dispozicion nga shtetasja xxx. Keto dokumenta kane te bejne me te ardhurat e perftuara prej saj ne Itali, te dhena mbi bilancet e aktivitetit tregtar te saj ne xxxx, te dhena ne lidhje me te ardhurat e djemve te saj ne Itali, etj.

Nga te dhenat e administruara nga ana e Intesa xx, rezulton se nga muaji Qershor 2012 deri ne Muajin nentor 2017, shtetasi Xxxx, ka derdhur ne llogarine e ish-bashkeshortes se tij, shtetases xx, ne formen e ndihmes ekonomike, nje shume prej 500 eurosh ne muaj.

Ne funksion te nje hetimi te plote dhe te gjithanshem, eshte vendosur kryerja e nje ekspertimi kontabel, me eksperte te fushes perkatese, me qellim evidentimin e te ardhurave dhe shpenzimeve, investimeve te kryera, te ardhurave te perfituara, etj, nga shtetasi Xxxx, xxxxxxxx.

Sipas aktit te ekspertimit ekonomik-kontabel te pergatitur nga ana e ekspertes xxxxxxxx, ka rezultuar se:

- Balanca midis teresise se te ardhurave te deklaruar dhe teresise se kostove te shtetasi Xxxx, rezulton te jete -302.492 Euro. Duke mbajtur ne konsiderate faktin se te ardhurat jane te realizuara pas vitit 2015, ndersa investimet kryesore jane realizuar para kesaj periudhe, rezultati i ndare sipas periudhave eshte: Deri ne vitin 2015, balanca midis teresise se te ardhurave te deklaruar dhe teresise se kostove eshte -381.842 Euro. Pamundesia financiare per realizimin e investimeve konsiston ne vlere absolute te jete 381.842 Euro, ose e shprehur ne perqindje rezulton te jete 99% e totalit te investimeve dhe shpenzimeve te kesaj periudhe; Per periudhen 2016-2018, balanca midis teresise se te ardhurave te deklaruar dhe teresise se kostove eshte +79.350 Euro. Xxxx ka patur mundesite financiare per te realizuar shpenzimet e vleresuara sipas dokumentacionit te arkivuar ne dosje te kesaj periudhe.

- Balanca midis teresise se te ardhurave te deklaruar dhe teresise se kostove te xxx, rezulton te jete +16.440 Euro. xxxxx ka patur mundesite financiare per te realizuar shpenzimet e vleresuara sipas dokumentacionit te arkivuar ne dosje.

- Balanca midis teresise se te ardhurave te deklaruar te xxx dhe teresise se kostove dhe investimeve te kryera prej saj ne emer te vet dhe ne emer te djemve te saj, xxxx, rezulton te jete +13.010 Euro. xxx ka patur te gjitha mundesite financiare per te realizuar keto investime dhe kostot e tjera te vleresuara sipas dokumentacionit te arkivuar ne dosje.

- Balanca midis teresise se te ardhurave te deklaruar te xxx dhe teresise se kostove dhe investimeve te kryera prej saj, rezulton te jete +18.424 Euro xxx ka patur mundesite financiare per te realizuar keto investime dhe kostot e tjera te vleresuara sipas dokumentacionit te arkivuar ne dosje.

Ne rrethana te tilla nga ana e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte akuzuar shtetasi Xxxx per kryerjen e vepres penale te "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", parashikuar nga neni 287/a/b/c i Kodit Penal.

Bazuar ne kete rrethane fakti, nga ana e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore, eshte kerkuar gjykimi i te pandehurit Xxxx per akuzen e parashikuar nga neni 287/a/b/c i Kodit Penal.

Rrethanat e faktit te pranuar nga gjykata u vertetuan me provat e administruara prova keto te marra gjate hetimeve paraprake dhe te pakontestuara nga palet, te cilat ne proceduren e gjykimit te shkurtuar marrin vleren e proves.

- Ne rrethana te tilla, ne veprimet e te pandehurit Xxxx, gjenden te konsumuara elementet e figures se kriminit te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale" te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal: "1. Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale kriminale, i kryer nepermjet: a) kembimit ose transferimit te pasurise, me qellim fshehjen ose mbulimin e

origjines se paligjshme te saj, duke ditur se kjo pasuri eshte produkt i vepres penale ose i veprimtarise kriminale; b) fshehjes ose mbulimit te natyres se vertete, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronesise ose te drejtave ne lidhje me pasurine, duke ditur qe kjo pasuri eshte produkt i vepres penale ose veprimtarise kriminale; c) Fitimit te pronesise, posedimit ose perdorimit te pasurise, duke e ditur ne çastin e marrjes se saj, qe kjo pasuri eshte produkt i vepres penale ose i veprimtarise kriminale; ç) kryerjes se veprimeve financiare ose transaksioneve te copezuara per shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit per parandalimin e pastrimit te parave; d) investimit ne veprimtari ekonomike ose financiare te parave a sendeve, duke ditur se jane produkte te vepres penale ose veprimtarise kriminale; dh) keshillimit, ndihmes, nxitjes ose thirrjes publike per kryerjen e seciles prej veprave te percaktuara me siper; denohen me burgim nga pese gjer ne dhjete vjet. 2. Kur kjo veper kryhet gjate ushtrimit te nje veprimtarie profesionale, ne bashkepunim ose me shume se nje here, denohet me burgim nga shtate deri ne pesembedhjete vjet. E njejta veper kur ka sjelle pasoja te renda , denohet jo me pak se pesembedhjete vjet me burgim. 3. Dispozitat e ketij neni zbatohen edhe kur vepra penale produktet e se ciles pastrohen eshte kryer nga nje person qe nuk mund te merret si i pandehur, nuk mund te denohet; ndjekja penale per vepren produktet e se ciles pastrohen eshte parashkruar ose amnistuar; personi qe kryen pastrimin e produkteve eshte i njejte me personin qe ka kryer vepren, nga e cila kane rrjedhur produktet; per vepren penale nga e cila kane ardhur produktet nuk eshte filluar asnjehere çeshtja penale apo nuk eshte dhene nje denim me vendim penal te formes se prere; vepra penale produktet e se ciles pastrohen, eshte kryer nga nje person, pavaresisht shtetesise se tij, jashte territorit te Republikes se Shqiperise dhe eshte njekohesisht e denueshme, si ne shtetin e huaj, ashtu edhe ne Republiken e Shqiperise”.

Qe per autorin te linde pergjegjesia penale sipas nenit 287 te Kodit Penal, duhet qe te vertetohet ekzistenca e nje vepre penale apo veprimtarie kriminale qe ka gjeneruar te ardhura. Pra kerkohet, ekzistenca e vepres penale nga e cila jane gjeneruar te ardhura, si dhe venia e ketyre te ardhurave ne qarkullim, me qellim mbulimin e origjines se tyre te kundraligjshme. Venia ne qarkullim e produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale, zakonisht behet nepermjet investimit ne biznese, rikapitalizimit te tyre ne ekonomi, perdorimit te transfertave te shpeshta bankare duke u perzier me burime te ligjshme te ardhurash apo duke i paraqitur ne teresi keto te ardhura si te ligjshme. Kjo veprimtari mund te kryhet si nga subjekti qe ka kryer vepren baze, pra nga subjekti qe ka kryer vepren penale baze nga e cila jane gjeneruar te ardhurat ashtu dhe nga subjekte te tjere ose persona te trete qe nuk kane marre pjese ne kryerjen e vepres penale baze (vepra meme), por qe kane dijeni per burimin e te ardhurave.

Rezultoi i provuar fakti se shtetasi Xxxx eshte arrestuar ne date 16.12.1996, per veprat penale te parashikuara nga nenet 71 dhe 72 dhe ligjit 685-1975 (posedim te lendeve narkotike mbi sasine e lejuar) si dhe per vepren penale te parashikuar nga neni x i Dekretit te Presidentit te Republikes 309/90. Rezulton se Gjykata xxx, ka denuar te pandehurin Xxxx per te njejtat vepra penale per te cilat eshte arrestuar, vendim i cili me vendimin me xxx dhe

xxxx, te Gjykates se Apelit ne Lecce, eshte riformuluar duke ripercaktuar denimin me 9 (nente) vjet burgim, per kryerjen e veprave penale te parashikuara nga nenet 71 dhe 72 dhe ligji 685/1975. Pra, provohet ekzistenca e vepres penale baze si nje nga kushtet e domosdoshme te figures se vepres penale te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Nga ana tjeter, referuar aktit te ekspertimit kontabel, provohet qe pasurite e evidentuara gjate hetimeve paraprake, qe jane blere nga ana e shtetasit xxxxx, te jene produkt i veprave penale per te cilat eshte denuar ky shtetas ne shtetin Italian. Nga akti i ekspertimit kontabel rezultoi qe shtetasi Xxxx, nuk ka pasur mundesi financiare per te kryer shpenzimet e evidentuara ne emer te tij.

Ne rrethana te tilla, i pandehuri Xxxx gjendet dhe do te shpallet fajtor per kryerjen e vepres penale te "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", parashikuar nga neni 287/1/a/b/c i Kodit Penal.

- Ne caktimin e llojit dhe te mases se denimit per te pandehurin Xxxx gjykata mban parasysh rrezikshmerine shoqerore te vepres penale, e shprehur ne sanksionin penal te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, i cili parashikon denimin vetem me burgim, si dhe rrezikshmerine shoqerore te autorit te kesaj vepre. Bazuar ne keto elemente gjykata çmon se denimi me i pershtatshem per te pandehurin eshte denimi i propozuar nga prokurori me pese vjet burgim (*mbi kete denim Gjykata do te aplikoje edhe nenin 406 te Kodit te Procedures Penale duke urdheruar zbritjen e 1/3 se denimit te dhene per shkak te procedimit me gjykim te shkurtuar*).

Ne arrijten e ketij konkluzioni gjykata mban parasysh rrethanat konkrete te kryerjes penale, rrethanat lehtesuese si dhe faktin qe ndaj te pandehurit nuk konkurron asnje rrethane renduese. Gjykata mban parasysh si rrethane ne favor te te pandehurit bashkepunimin me organin e akuzes, I pandehuri i ka pranuar aktet ne gjendjen qe jane paraqitur nga organi i akuzes, pa asnje kontestim. Ka zgjedhur te mbrohet me nje avokat te zgjedhur prej tij, duke marre pjese me korrektese ne gjykim, dhe duke mos shkaktuar zvarritje dhe kosto te qellimshme apo te pajustificueshme gjyqesore.

Gjykata mban parasysh si rrethana lehtesuese ne kuptim te nenit 49 te Kodit Penal, m pandehurit, personalitetin dhe zhvillimin e tij dhe rrethanat e veshtira familjare te te pandehurit si dhe faktin qe i pandehuri ka probleme kronike shendetesore. Gjithashtu gjykata mban parasysh edhe faktin qe i pandehuri eshte person pa precedente penale cka ndikon ne vleresimin e rrezikshmerise shoqerore te tij.

Bazuar ne gjitha rrethanat e mesiperme te provuara ne gjykim, gjykata cmon se e denimit me burgim ndaj te pandehurit duhet te pezullohet duke u vene i pandehuri ne prove, me kusht qe gjate kohes se proves te mos kryeje veper tjeter penale.

Neni 59 i Kodit Penal parashikon: **"1. Per shkak te rrezikshmerise se pakte te personit, moshes, kushteve shendetesore apo mendore, menyres se jeteses dhe te nevojave, veçanerisht atyre qe lidhen me familjen, shkollimin ose punen, rrethanave te kryerjes se vepres penale, si dhe te sjelljes pas kryerjes se vepres penale, gjykata, kur jep denim me burg deri ne pes? vjet, mund te urdheroj? qe i denuari te mbaje kontakte me sherbimin e proves dhe te vihet ne prove, duke pezulluar ekzekutimin e denimit, me kusht qe gjate kohes se proves te mos kryeje veper tjeter penale. 2. 3. Per denimet e dhena deri ne dy vjet burgim, te pezulluara nga gjykata, afati i proves eshte sa dyfishi i kohes se denimit me burgim te dhene nga gjykata. 4. Afati i proves, me perjashtim te rregullit te parashikuar ne paragrafin 3 te ketij neni, eshte 24 muaj deri ne 5 vjet. Afati i proves fillon, nga e nesermja shpalljes se vendimit te gjykates qe ka dhene vendim per pezullimin e denimit me burgim....."**

Gjykata cmon se pezullimi i ekzekutimit te denimit me burgim, i kerkuar edhe nga organi i akuzes, si alternative e denimit me burgim per te pandehurin Xxxx eshte alternativa me e pershtatshme ne gjykimin e rastit konkret. Gjykata arrin ne kete konkluzion duke pasur parasysh rrezikshmerine e ulet te te pandehurit, sjelljen e tij ndaj procedimit penal, ekzistencen e disa rrethanave lehtesuese ne ngarkim te tij, rrethanat ne te cilat eshte kryer vepra penale sidomos gjendjen e veshtire shendetesore te te pandehurit, rrethanat familjare si dhe mundesine e rehabilitimit te te pandehurit.

Ne arrijten e ketij perfundimi gjykata mban parasysh edhe jurisprudencen e krijuar nga Gjykata e Larte e cila ne situata analoge ka vendosur pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim (permendim Vendimin Nr.267, date 09.10.2013, te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte; Vendimin Nr.285, date 06.11.2013, te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte; Vendimin Nr.194, date 04.07.2012, te Kolegjit Penal

te Gjykates se Larte; Vendimin Nr.151, date 18.06.2014, te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte).

Gjykata, bazuar ne denimin e dhene ndaj te pandehurit Xxxx, ne raport me pa e nenit 59/4 i Kodit Penal, do ta vere te pandehurin Xxxx ne prove per nje afat kohor tre vjet, me kusht qe i pandehuri gjate kesaj kohe te mos kryejne vepra penale. Ne caktimin e ketij afati gjykata udhehiqet nga rrethanat e kryerjes se vepres penale, duke e cmuar si afatin me te pershtatshem per te pandehurin ne perputhje me realizimin e qellimit ndeshkues por edhe rehabilitues te denimit penal. Gjykata ne baze te nenit 61 te Kodit te Procedures Penale do te urdheroje te pandehurin te zbatoje detyrimet e percaktuara gjate kohes se proves dhe te marre pelqimin nga sherbimi i proves per ndryshimin e vendbanimit apo per levizjet e shpeshta brenda vendit.

Bazuar ne nenin 190 te Kodit te Procedures Penale, per sendet e sekuestruara me vleren xxxxx te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, bazuar ne konkluzionet e akti te ekspertimit kontabel, te gjitha pasurite e kontraktuara nga i pandehuri Xxxx dhe qe rezultojne te regjistruara ne favor te tij, pra: Garazhet nrxxxx, me siperfaqe 31.5 m2, ndodhur ne lagjen "10 Korriku", blere per cmimin e 12.000 Euro, me kontraten nr.547/271, date 11.05.2013; Vendparkimet xxxxx, ndodhur ne nje objekt shumekatesh ne lagjen "Pavaresia" Vlore, blere nga shtetasi Xxxx per cmimin e 40.000 Euro me kontraten nr.3462/1739, date 12.10.2012 si edhe nja Automjet tip BMW X5, me xxxx, me nr.shasie xxxxx, vit prodhimi 2008, i blere ne shumen prej 22.000 euro, do te konfiskohen dhe do te kalojne ne favor te shtetit. Persa u perket sendeve te tjera te sekuestruara me vendimin me xxxxx, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, qe u perkasin xxxxx, xxxxx, do te hiqet masa e sigurimit pasuror te sekuestros preventive.

Ne aktin e ekspertimit kontabel, ne faqen 6 te tij, eshte analizuar edhe nje "kontrat drejtash pasurore", xxxx perpiluar nga notere xxxxx, ku percaktohet se vendparkimet nr.xxx, te ndodhura ne katin -1, ndermjet akseve C-D, i jane kaluar nga xxxx, per vleren 15.000euro. Ne aktin e ekspertimit kur jane analizuar mundesite financiare te shtetases xxxxx per te kryer investimet objekt hetimi pasuror, eshte perfshire edhe shuma 15.000euro (e permendur nga ekspertja ne faqen nr.6 te aktit te ekspertimit), dhe ka rezultuar se balanca midis teresise se te ardhurave te deklaruar dhe teresise se kostove dhe investimeve te kryera prej saj, rezulton te jete +18.424 Euro. Pavaresisht ketij fakti, nuk rezulton qe gjate hetimit dhe gjykimit te kesaj çeshtjeje penale te jete marre ne cilesine e proves "kontrate cedim te drejtash pasurore", nr.xxxx, perpiluar nga notere xxxx, per rrjedhoje gjykata sikurse ka permendur me lart, do te urdheroje konfiskimin e ketyre dy vendparkimeve te cilat rezultojne te jene ne pronesi te te pandehurit Xxxx.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te neneve 47, 48/ç, 49, 287/1/a/b/c te Kodit Penal dhe neneve 190, 390, 406 te Kodit te Procedures Penale.

VENDOSI

- Deklarimin fajtor te te pandehurit Xxxx per kryerjen e vepres penale te "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale" dhe ne baze te nenit 287/a/b/c te Kodit Penal e denon me 5 (pese) vjet burgim.
- Ne baze te nenit 406 te Kodit te Procedures Penale urdherohet zbritja e 1/3 e mases se denimit.
- Ne baze te nenit 59 te Kodit Penal urdherohet pezullimi i ekzekutimit te denimit me burgim per nje afat kohor 3 (tre) vjet.
- Ne baze te nenit 60 te Kodit Penal urdherohet i pandehuri Xxxx te mbaje kontakte me sherbimin e proves dhe te zbatoje detyrimet e percaktuara gjate kohes se proves.

•Ne baze te nenit 61 te Kodit Penal detyrohet i pandehuri Xxxx te marre pelqimin nga sherbimi i proves per ndryshimin e vendbanimit apo per levizjet e shpeshta brenda vendit.

•Ne baze te nenit 190/1/b te Kodit te Procedures Penale, sendet e sekuestruara me vendimin me Nr.2029, date 17.11.2018 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore:

- Garazh me nr.16 dhe garazh nr.17, me sip tot "10 Korriku", objekt banimi 6-8 kate, 1-kat dyqan, 5-7 kate +1-kat parkim ne toke, blere per cmimin e 12.000 Euro, me kontraten nr.547/271, date 11.05.2013, lidhur ndermjet shoqerise "xxxxx" dhe shtetasit Xxxx, te konfiskohen dhe te kalojne ne favor te shtetit.

- Vendparkim xxxxx.14, ndodhu parkim nen toke, ndertuar sipas lejes se ndertimit miratuar me vendimin me xxxx, te KRRT-se Bashkise Vlore, ne lagjen "xxx" Vlore, blere nga shtetasi Xxxx per cmimin e 40.000 Euro (para nenshkrimit te kesaj kontrate eshte likujduar shuma prej 20.000 Euro, pjesa e mbetur ne vijim deri ne daten 28.02.2015), blere me kontraten "Premtim shitje", nr.3462/1739, date 12.10.2012, lidhur ndermjet shoqerise xxxxxxxxxxxx sh.p.k dhe shtetasit Xxxx, te konfiskohen dhe te kalojne ne favor te shtetit.

- Automjet tip BMW X5, me xxxx, me prodhimi 2008, i blere ne shumen prej 22.000 euro, te konfiskohet dhe te kaloje ne favor te shtetit.

- Dyqan me sip 57 m2, ndodhur ne nje objekt 13 ndertuar sipas lejes se ndertimit miratuar me vendimin me Nr.2/284, date 28.09.2011, te KRRT-se Bashkise Vlore, ne xxxx , blere me kontraten "Premtim shitje dyqani" nr.2360/1167, date 23.08.2014, ndermjet shoqerise "xxxx.p.k dhe shtetasit xxx, per cmimin e 25.000 euro Euro, te hiqet masa e sigurimit pasuror te sekuestros preventive dhe ti kthehet pronarit te ligjshem shtetasit xxx

- Apartament banimi nr.9/B me sip 65 m2, garazh lagjen "10 Korriku", objekt banimi 6-8 kate, 1-kat dyqan, 5-7 kate +1-kat parkim ne toke, blere per cmimin e 37.000 Euro, me kontrate porosie nr.xxxx, ndermjet shoqerise xxx" dhe shtetasit xxxx, te hiqet masa e sigurimit pasuror te sekuestros preventive dhe ti kthehet pronarit te ligjshem shtetasit xxxxx.

Apartament banimi nr 10/B me sip 62 m2; gar totale 28.9 m2, ndodhur ne lagjen "xxx", objekt banimi 6-8 kate, 1-kat dyqan, 5-7 kate +1-kat parkim ne toke, blere per cmimin e 35.000 Euro, me kontrate sipermarrije per prenotim apartamenti nr.xxxx date 10.05.2013, lidhur ndermjet shoqerise "xxxx" dhe shtetasit xxxx, te hiqet masa e sigurimit pasuror sekuestro preventive dhe ti kthehet pronarit te ligjshem shtetasit xxxx.

- Njesi sherbimi dyqan, me sip 43.8 m2, ndodhur cmimin 135.780 euro, me kontraten nr.xxx, date 05.10.2012, kontrate premtim shitje, lidhur ndermjet shtetasit xxxx dhe shtetasit Xxxx, pasuri e cila me pas i ka kaluar shtetases

xxxx, te hiqet masa e sigurimit pasuror sekuestro preventive dhe ti kthehet pronarit te ligjshem shtetases xxx.

•Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen te pandehurit Xxxx.

•Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes.

Vlore me 14.10.2020

SEKRETARE

Iva LLUPA

Mirela MISHGJONI

Për këto arsye

VENDOSI:

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

Mirela Mishgjoni